

MORTEL M5



PËRSHKRIMI

Material mbushës themelor për mure tulle ose blloku për ambiente te brendshme ose të jashtme.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

Material në formë pluhuri me bazë: çimento, gëlqere, rëre guri me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditivë special.

- Karakterizohet nga një punueshmëri mjaft e mirë.
- Rezistencë e lartë mekanike
- Pa rrëshqitshmëri vertikale
- Aftësi ngjitëse në mure dhe tavane.

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

Përdoret si llaç themelor për suvatimin e të gjitha llojeve të suporteve si mureve prej tulle, blloku etj. Produkti aplikohet me makineri ose me dorë. Gjatë aplikimit të produktit temperatura e suportit dhe temperatura e ambientit duhet të jenë nga +5°C deri në +35°C.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Forma:	Pluhur
Ngjyra:	Gri
Djegshmëria:	I padjegshëm
Kërkesa për ujë:	6 - 6.5 Lt/ 25 Kg
Dendësia e llaçit të thatë	1.9 gr/cm ³
Konsistenca:	Tiksotropike
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Kohëzgjatja e përzierjes:	3 - 4 orë
Koha e punueshmërise:	30 min
Trashësia maksimale:	1.5 cm
Rezistenca në shtypje:	≥ 3. 5 N/mm ²
Koha e ngurtësimit	385 min

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përzieni 25 Kg pluhur llaç Mbushës me 6.5 - 7 litra ujë me anë të një përzierësi elektrik ose në mënyrë manuale, derisa të përftohet një masë e përshtatshme për punueshmërinë e kërkuar. Mund të punohet edhe me pompë.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Suporti ku do të aplikohet materiali duhet të jetë i thatë, i pastër, i njëtrajtshëm, absorbues, i qëndrueshëm. Nuk duhet të ketë mbetje të huaja si vajra, verniqe, naftë, etj. Në sipërfaqen ku do të aplikohet materiali nuk duhet të ketë fenomene të tilla si fluoreshenca.

APLIKIMI

Produkti aplikohet në mënyrë manuale, me mistri ose në mënyrë mekanike me pompë. Kur produkti aplikohet me pompë duhet pasur kujdes konsistenca e përpunimit. Mos e përzieni me materiale të tjera përveç Latex. Në rast pauzash më të gjata, përzierësi duhet të lihet bosh dhe të pastrohet. Llaçi i freskët duhet përpunuar brenda 2 orëve. Mbroni tullat dhe llaçin (mbi të gjitha gjatë ndërprerjes së punës) nga shiu. Në rast se temperaturat janë të larta rekomandohet që llaçi të spërkatet pak me ujë përpara se të thahet në mënyrë që të mos humbasë ujin.

PËRFORCIMI ME LATEX

Për t'i përmirësuar ngjitshmërinë, papërshkueshmërinë nga uji, plasticitetin, elasticitetin, forcën mekanike etj, llaçi mund të përforcohet me aditivin LATEX. Raporti i përzierjes është 1:5 në ujë.

KONSUMI

15Kg/m²/mm

PAKETIMI

25 Kg

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkonin ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

